



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 101 Akti

Nr. 92 Vendimi
Tiranë, më 20.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Xhensila Pine	Anëtar
Firdes Shuli	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 18 dhjetor 2018, ora 14:00 dhe më datë 20.12.2018 ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket :

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Izet Kadana**, gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet e provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Izet Kadana, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tre kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Izet Kadana, është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Pukë, dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Pukë nga viti 1994, dhe prej vitit 2016 është emëruar kryetar i kësaj gjykate. Ky subjekt është shortuar nga Komisioni me shortin e datës 15.03.2018.

3. Me shkresën nr. (***) prot., datë 18.01.2018, protokolluar pranë Komisionit me nr. (***) prot., datë 29.01.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana (10 fletë).

4. Me shkresën nr. (***) prot., datë 12.11.2018, protokolluar pranë Komisionit, me nr. (***) prot., datë 12.11.2018, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës me nr. (***) prot., datë 09.11.2018, të deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së, nr. (***), datë 12.11.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana (3 fletë).

5. Me shkresën nr. (***) prot., datë 17.07.2018, protokolluar pranë Komisionit, me nr. (***) prot., datë 25.07.2018, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana (29 fletë).

6. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”), ka zhvilluar shortin, më datë 15.03.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga 3 komisionerët Alma Faskaj, Firdes Shuli dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes

Shuli. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, Komisioni, ka vendosur që komisionere Alma Faskaj, për arsye objektive, të zëvendësohet nga komisionerja Xhensila Pine.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues administroi:

7.1 Aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar si “ILDKPKI”);

7.2 Raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”).

7.3 Raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar si “KLD”).

8. Me vendimin nr. 1, datë 20.03.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Izet Kadana, duke përfshirë të tre kriteret, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Komisionere Xhensila Pine, e cila ka zëvendësuar komisioneren Alma Faksaj, ka deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, ditën e zëvendësimit të saj, më datë 16.07.2018.

9. Me vendimin nr. 2, datë 27.11.2018, trupi gjykues vendosi:

9.1 Të përfundojë hetimin paraprak administrativ për të tre kriteret e parashikuara në nenin 4, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, kriterin e pasurisë, të figurës dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana.

9.2 Të miratojë rezultatet paraprake të hetimit.

9.3 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

9.4 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9.5 Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin brenda të cilit (10.12.2018) mund t’i ushtrojë këto të drejta.

10. Më datë 03.12.2018, subjekti paraqiti në rrugë elektronike kërkesë për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, komisionere Xhensila Pine.

11. Me vendimin nr. 2, datë 04.12.2018, Komisioni, vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, për përjashtimin e komisioneres Xhensila Pine, vendim i cili i është njoftuar subjektit elektronikisht, në datë 04.12.2018.

12. Më datë 05.12.2018, subjekti paraqiti kërkesë për shtyrje afati për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova mbi rezultatet e hetimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, nga ana e Komisionit u zgjat afati për tre ditë, nga data 10.12.2018 - 13.12.2018.

13. Më datë 10.12.2018, subjekti paraqiti një tjetër kërkesë për shtyrjen e afatit me 10 ditë, për të dhënë shpjegime e paraqitur prova, duke argumentuar, se nga data 03.12.2018 - 09.12.2018 ka qenë nën regjim ambulator e regjim shtrati, e për këtë arsye nuk ka mundur të marrë dokumentet që do t'i shërbenin si provë nga "Raiffeisen Bank", dega Pukë, si dhe të ushtrojë të drejtën e aksesit në dosje.

14. Me vendimin nr. 3, datë 10.12.2018, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin për ushtrimin e të drejtës për t'u njohur me dosjen dhe paraqitjen e provave të reja, deri më datë 17.12.2018, ora 16:00, si dhe të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, më datë 18.12.2018 ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, sipas nenit 55, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

15. Më datë 17.12.2018, pavarësisht se nuk e ushtroi të drejtën e njohjes me dosjen, vuri në dispozicion në rrugë elektronike shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit paraprak.

16. Më datë 18.12.2018, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit "*Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave*", trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana, bazuar në të tre komponentët: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1 VLERËSIMI I PASURISË

II.1. a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016. Më datë 27.01.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar "Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting" pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me aktin nr. (***)prot., datë 18.01.2018, ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II.1.b. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin, sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- a) Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- b) Verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- c) Evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- ç) Evidentimin e deklaratimeve të rreme;
- d) Nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë si vijojnë:

1.Apartament banimi 1+1, me sipërfaqe 62.02 m², ndodhur në qytetin Pukë, banesa nr. 47, shk.1, kati 3, blerë me aktin noterial, nr. (***), datë 15.12.1996, në vlerën 400.000 lekë, regjistruar me numër pasurie (***), datë 25.03.1996, e vërtetuar nga dokumenti hipotekor, nr. (***), datë 25.03.1996. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i deklaruar i krijimit janë:

- të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes;
- të ardhurat nga shitja e një dyqani ushqimor në Pukë, i blerë me aktin noterial nr. (***), datë 17.01.1994, në vlerën 33.634 lekë dhe shitur me aktin notarial, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.12.1995, në vlerën 600 000 lekë.

1.1. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se:

1.1.a. ZVRPP Pukë¹ konfirmoi se, z. Izet A. Kadana, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme Pukë, pasurinë nr. (***), vol. (***), fq. (***), ZK (***), lloji i pasurisë apartament, me sipërfaqe 62.02 m², blerë sipas aktit të shitblerjes, datë 15.12.1995, në vlerën 4.000.000 lekë, për të cilën është bërë RVP, më datë 26.01.2012, në shumën 1.407.047 lekë. ZVRPP-ja ka vënë në dispozicion praktikën e origjinës dhe regjistrimit të kësaj pasurie (gjithsej katër fletë). Ky institucion ka sqaruar çdo paqartësi lidhur me numrin e kësaj pasurie².

1.1.b. OSHEE-ja³ konfirmon se, z. Izet A. Kadana, është abonent vetëm i një kontrate nr. (***), në instancën e Shkodrës, e cila i përket pasurisë objekt shqyrtimi.

1.2 Kjo pasuri është deklaruar:

1.2.a. Në deklarin për vitin 2003, si apartament banimi 1+1, me sip. 72 m², vlera 1.2 milion lekë, ndodhur në qytetin Pukë, me burim krijimi të ardhurat e subjektit si dhe fitimi nga shitja e një dyqani. Pjesa takuese: 100 %,

1.2.b Në deklarin për vitin 2004, si apartament banimi 1+1, me sip. 72 m², vlera 400.000 lekë. Bashkëpronësi me bashkëshorten 50 %.

1.2. c. Në deklaratën “Vetting”, është deklaruar si në pikën 1 më sipër.

1.3. Nga deklarinet periodike, kanë rezultuar pasaktësitë si vijojnë:

1.3.a Ka mospërputhje në deklarinet e subjektit për sipërfaqen e apartamentit, vlerën e pasurisë, dhe pjesën takuese;

1.3.b Ka mospërputhje të vitit të blerjes së apartamentit të deklaruar në deklaratën “Vetting” (1996) me kontratën e shitjes (1995);

1.3.c Në deklarin për vitin 2003, ka mosdeklarim të të ardhurave nga shitja e një mjete në shumën prej 200.000 lekësh;

1.3.d Ka mospërputhje në deklaratën “Vetting” lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë, pasi në këtë deklaratë, vlera e deklaruar është 400.000 lekë, ndërsa në kontratën e shitjes e cila ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë pranë ZVRPP-së, çmimi i blerjes është 4.000.000 lekë.

1.4. Këto mospërputhje dhe pasaktësi, janë sqaruar nga ana e subjektit⁴ si vijon:

1.4.a Në deklaratën për vitin 2003 ai deklaroi se e ka shënuar gabimisht sipërfaqen 72 m², ndërkohë që realisht sipërfaqja është 62.02 m², duke u konsideruar një gabim material nga ana e tij.

1.4.b Për sa i përket çmimit të blerjes së deklaruar për vitin 2003 (1.2 milion lekë), sqaron se në deklaratën për vitin 2003, duke qenë se ishte deklarimi i parë, kishte deklaruar vlerën e tregut në

¹ Shih, shkresën kthim përgjigje me nr. (***)prot., datë 18.04.2018, të ZVRPP-së Pukë, në dosjen e Komisionit.

² Shih, shkresën nr. (***)prot., datë 27.09.2018, të ZVRPP-së Pukë, në dosjen e Komisionit.

³ Shih, shkresën kthim përgjigje nr. (***) prot, datë 22.10.2018, nga OSHEE, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shih, përgjigjet e subjektit dërguar, në datë 04.10.2018, për pyetësin nr. 2, në dosjen e Komisionit, pika 2-a.

këtë vit të blerjes së pasurisë. Pasuria ishte blerë në vitin 1995 në vlerë 400.000 lekë dhe gjatë viteve, vlera e saj në treg u rrit. Në vitin 2003, vlera e pasurisë ka qenë afërsisht rreth 1.2 milion lekë.

1.4.c Për sa i takon pjesës takuese, subjekti deklaroi se ka shënuar gabimisht pjesën takuese: 100 % , në deklarin për vitin 2003, por më vonë në deklaratat pasardhëse e ka riparuar këtë parregullsi, duke marrë parasysh regjimin pasuror martesor 50% me 50% me bashkëshorten, znj. S. K. Sipas tij, të gjitha këto mangësi kanë qenë për shkak se viti 2003, ka qenë deklarimi i parë dhe nuk ka pasur njohuri të plota në lidhje me mënyrën e plotësimit të deklaratës.

1.4.ç Për sa i përket vlerës së këtij apartamenti, ka sqaruar se vlera e blerjes ka qenë 400.000 lekë dhe jo 4.000.000 lekë siç është shënuar në aktin noterial të datës 15.12.1995. Kjo vlerë, është shënuar gabimisht nga ana e noterit në lekë të vjetra 4.000.000 lekë, kur në të vërtetë duhej shënuar 400.000 lekë (të rinj). Sipas tij, vlera maksimale në treg e një apartamenti 1+1 në qytetin e Pukës në vitin 1995, mund të ishte deri në 500.000 lekë i rikonstruktuar.

1.4.d Për sa i takon mosdeklarimit në vitin 2003 të të ardhurave nga shitja e automjetit në shumën 200.000 lekë, sqaron se ka qenë një gabim në deklarim, pasi ka qenë deklarimi i parë dhe nuk kishte njohuri të mjaftueshme për plotësimin e formularëve të deklarimit të pasurisë.

1.4.e. Për sa i takon mospërputhjes së vitit të blerjes së pasurisë në deklaratën “Vetting” ku është shënuar viti 1996, me kontratën e shitjes, ku është shënuar viti 1995, sqaron se ka qenë një lapsus nga ana e tij.

Arsyetim lidhur me pasaktësitë në deklarime:

Trupi gjykues, pasi mori në konsideratë sqarimet e subjektit të rivlerësimit, në përfundim krijoi bindjen se mospërputhjet në deklarimet e subjektit në lidhje me sipërfaqen e apartamentit, pjesën takuese dhe vitin e blerjes, si dhe mosdeklarimi i të ardhurave nga shitja e automjetit në vitin 2003, janë formale, duke i çmuar ato si gabime materiale e të paqëllimshme, nga të cilat nuk kanë ardhur pasoja ligjore të parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Si të tilla, ato nuk janë konsideruar si shkaqe ligjore në kuptim të ligjit nr. 84/2016, për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me mospërputhjen e vlerës së pasurisë në deklaratën “Vetting” (400.000 lekë) me kontratën e shitblerjes (4.000.000 lekë), Komisioni, krijoi bindjen se pavarësisht çmimit prej 4.000.000 lekësh të shënuar në kontratën për shitjen e se pasurisë, kontratë e cila është dokument zyrtar i vënë në dispozicion nga ZVRPP Puke⁵, vlera e blerjes së kësaj pasurie në vitin 1995 ka qenë 400.000 lekë dhe jo 4.000.000 lekë.

Për të arritur në këtë vlerësim, Komisioni, morri në konsideratë përveç pretendimeve të subjektit, edhe faktet si vijojnë :

- Në aktin origjinal të shitblerjes datë 15.12.1995, të depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, pasqyrohet e shënuar me shkrim dore, se çmimi i shitjes prej 400.000 lekë, është me lekë të vjetra.

⁵ Shih, shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 14.11.2018, nga ZVRPP-ja Pukë, në dosjen e Komisionit.

- Në të gjitha deklaratimet periodike, përjashtuar atë për vitin 2003, vlera e kësaj pasurie është deklaruar 400.000 lekë.
- Më datë 26.01.2012 është kryer rivlerësimi⁶ i kësaj pasurie në vlerën 1.407,047 lekë, pra në një vlerë dukshëm më e ulët nga vlera prej 4.000.000 lekë (praktikisht e pamundur).
- Vlera mesatare⁷ për 1 m² sipërfaqe të shfrytëzuar sipas tregut të lirë të shitjes së apartamenteve për vitin 1995 në qytetin e Pukës, ka qenë 6.40 lekë/m². Nga një llogaritje aritmetike, një apartament me sipërfaqe 62.02 m² në qytetin e Pukës në vitin 1995, nuk do të kushtonte më shumë se 396.928 lekë/m², e përafërt me vlerën prej 400.000 lekësh.

1.5 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie:

Si burim krijimi për këtë pasuri janë deklaruar:

1.5.a. Kursime familjare, të cilat janë marrë në shqyrtim gjatë analizës financiare.

1.5.b. Të ardhurat nga shitja e një dyqani në Pukë, për të cilin u verifikua se:

- Me aktin noterial nr. (***) , datë 17.01.1994, është blerë pasuria dyqan ushqimor, në vlerën 33.634 lekë, nga shitësja S. H.⁸.

- Me aktin noterial nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.12.1995, z. Izet Kadana, në cilësinë e shitësit i ka shitur blerëses L. I. F., dyqan ushqimor të ndodhur në fshatin (***) të rrethit Pukë me vlerë 600.000 lekë të reja⁹, shumë e cila ka shërbyer si burim të ardhurash për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi, pasuria nr.(***) .

Nga analiza financiare për periudhën përpara vitit 2003 dhe për vitin 2003¹⁰, të përmbledhura në tabelën e mëposhtme, rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kursimet e deklaruara dhe shpenzimet e kryera në vitin 2003, në vlerën 314.643 lekë.

Ndërkohë, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 400.000 lekë për periudhën para vitit 2003.

	Përshkrimi	Para vitit 2003	Viti 2003
1	PASURI	900,000	-
	Apartament banimi 1+1, me sip.62.02 m ² , në Pukë	400,000	-
	Autoveturë, tip “Mercedes-Benz”	500,000	-
2	DETYRIME	-300,000	-
	Hua dhënë “(***)”	-300,000	-

⁶ Shih, shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 27.09.2018, nga ZVRPP-ja Pukë, në dosjen e Komisionit.

⁷ Shih, vendim nr. 815, datë 09.12.1996, “Për miratimin e vlefave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vlefës së koeficientit “K”.

⁸ Shih, vërtetimin e ZVRPP-së Pukë, nr. (***) prot., datë 17.10.2016, të depozituar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shih, kontratën nr. (***) datë 13.12.1995, të depozituar nga subjekti në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Analiza financiare përpara vitit 2003, ka qenë e domosdoshme për tu bërë, për shkak se në deklarin periodik për vitin 2003 subjekti ka deklaruar blerjen e një apartamenti banimi dhe një autoveturë, si dhe të ardhura, shpenzime e kursime familjare.

3	PASURI NETO	1,200,000	-
4	TË ARDHURA	4,876,236	1,258,322
	Të ardhura nga shitja e dyqanit ushqimor në vitin 1995	566,366	-
	Të ardhura nga shitja e makinës në vitin 2003	-	200,000
	Të ardhura nga paga e subjekti të dokumentuara	3,050,975	739,116
	Të ardhura nga paga bashkëshortja të dokumentuara	1,258,895	319,206
5	SHPENZIME	1,430,000	642,857
	Shpenzime jetese	1,430,000	642,857
7	LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	-	930,108
	Llogari depozite bankare Banka e Kursimeve Pukë, në emër të bashkëshortes, e padokumentuar.	-	730,108
	Gjendje CASH sipas deklarimeve	-	200,000
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 4-3-5-7)	2,246,236	-314,643

1.6. Barra e provës:

Duke qenë se subjekti nuk ka paraqitur dokument shkresor për të vërtetuar depozitën bankare në shumën prej 730.108 lekësh në emër të bashkëshortes së tij, të deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, atij iu kalua barra e provës.

Në përgjigjet e datës 17.12.2018, subjekti vuri në dispozicion vërtetimin me nr. (***) prot., datë 14.12.2018, lëshuar nga “Raiffesien Bank”, dega Pukë, ku vërtetohet se bashkëshortja e tij, zj. S. K., më datë 31.12.2003, figuron në kartelën me nr. (***), me një depozite me afat 6 mujor për shumën prej 709.149 lekësh, e cila është mbyllur më datë 24.02.2005. Si rrjedhim depozita në shumën prej 730.108 lekësh, është marrë në konsideratë gjatë analizës financiare.

2. Autoveturë, tip “Daimler Chrysler” (Mercedes benz), në vlerën 5.250 euro, ekuivalente në vlerën 730.000 lekë, e pazhdoganuar dhe më pas zhdoganuar në degën e Doganës Durrës në vlerën 257.669 lekë, sipas mandatit nr. (*), datë 07.07.2011, të “BKT”-së Durrës dhe aktit të zhdoganimit më datë 07.07.2011, gjithësej vlere 987 669 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

Burim krijimi të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga paga.

2.1. Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, konfirmon¹¹ pronësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, mbi mjetin me targë: (***) (blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.12.2010.

¹¹ Shih, shkresën nr. (***) prot., datë 26.04.2018, të DPSHTRR-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

2.2. Kjo pasuri është deklaruar :

2.2.a Në deklarin për vitin 2010, si pakësim pasurie për blerjen e këtij mjeti në vlerën 5.250 euro me aktin notarial, nr. (***) kol., nr. (***) kol., datë 30.12.2010.

2.2.b Në deklarin për vitin 2011, si pakësim pasurie, në shumën prej 257.669 lekësh, për zhdoganimin e këtij mjeti, detyrim ky sipas aktit noterial, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 30.12.2010.

2.2.c. Në deklaratën “Vetting” si autoveturë, me targë (***), deklaruar si në pikën 1 më sipër.

Nga hetimi administrativ, nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime dhe as dyshime lidhur me këtë pasuri. Përputhen deklarinimet e subjektit me dokumentet e administruara.

Nga analiza financiare për vitin 2010, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e makinës.

3. Autoveturë, tip “Peugeot”, me nr. (***) shasio, viti i prodhimit 2004, blerë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., me aktin notarial, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 26.03.2012, në vlerën 3.200 euro, ekuivalente në vlerën 448.000 lekë, e zhdoganuar. Certifikata e pronësisë së mjetit nr. (***) lëshuar, më datë 28.03.2012, nga DRPSHTRR Shkodër. Blerë me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga paga. Kjo pasuri është deklaruar edhe nga bashkëshortja e subjektit.

3.1 Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, konfirmon¹² mjetin me targë (***), në emër të, znj. S. A., blerë me kontratë shitje pasurie e luajtshme, datë 26.03.2012, nga shtetasi S. B., me vlerë 3.200 euro.

3.2. Nga deklarinimet ndër vite, ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar:

3.2.a Në deklarin për vitin 2012, si pakësim të ardhurash në shumën prej 3.200 eurosh e barabartë me 448.000 lekë, që rrjedh nga blerja e një automjeti, tip “Peugeot”, viti i prodhimit 2004, nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., me aktin notarial, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 26.03.2012, me certifikatë pronësie, nr. (***), datë 28.03.2012. Makina është blerë e zhdoganuar.

3.2.b. Është deklaruar në deklaratën “Vetting”, si në pikën 3 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime dhe dyshime lidhur me këtë pasuri. Përputhen deklarinimet e subjektit me dokumentet e administruara.

Nga analiza financiare për vitin 2012, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shpenzimet e kryera gjatë vitit 2012 dhe për të justifikuar blerjen e makinës.

¹² Shih, shkresën kthim përgjigje, nr. (***) prot, datë 26.14.2018, të DPSHTRR-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

4. Hua e dhënë pa interes në shumën 7.000.000 lekë, shtetasit M. M., sipas deklaratës së datës 03.04.2014, vërtetuar me aktin noterial, nr. (***) rep., datë 17.09.2014, dhe deklaratës datë 03.04.2016, vërtetuar me aktin notarial, nr. (***) rep., datë 06.10.2016.

4.1 Nga hetimi administrativ u konstatua se :

4.1.a Sipas deklaratës së deklaruesit M. M., datë 03.04.2014, me vërtetim nënshkrimi nga noter D. M., shtetasi M. M., deklaroi se i ka marrë hua shtetasit Izet Kadana shumën prej 7.000.000 lekësh, pa shpërblim, interes apo kamatë vonesë me afat 2 vjet.¹³

4.1.b Sipas deklaratës së deklaruesit Izet Kadana, datë 03.04.2016, me vërtetim nënshkrimi nga noter D. M., ai deklaroi se afati i huas së dhënë z. M. M. shtyhet edhe për 2 vjet.¹⁴

4.1.c Kjo shumë është raportuar pranë DPPPP-së nga noteri D. M.¹⁵.

4.2 Nga deklaratimet periodike, rezulton se kjo hua është deklaruar :

4.2.a Në deklarinimin për vitin 2014, dhënë hua pa interes shumën 7.000.000 lekë me afat brenda 2 vitesh shtetasit M. M. Pjesa takuese: 50 % me bashkëshorten.

4.2.b Në deklarinimin për vitin 2015, dhënë hua pa interes në shumën prej 7.000.000 lekësh me afat brenda 2 vitesh shtetasit M. M.

4.2.c Në deklarinimin për vitin 2016, dhënë hua pa interes në shumën 7.000.000 lekë me afat brenda 2 vitesh shtetasit M. M.

4.2.d Në deklaratën “Vetting”, si në pikën 4 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarinime.

4.3 Lidhur me konfliktin e interesit me shtetasin M. M., i konsideruar si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 3 pika 14 të ligjit nr. 84/2016:

4.3.a. Janë administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrëdhënien midis tyre dhe arsytet e dhënies së huas pa interes. Sipas tij ¹⁶, ... *me shtetasin M. M. ka lidhje krushqie, pasi bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., e ka djalin e xhaxhait.... huaja i është dhënë atij për të ndihmuar në atë kohë biznesin e tij pasi ka pasur probleme financiare, pa shpërblim, për shkak të lidhjeve miqësore....afati i kësaj huaje është zgjatur meqenëse huamarrësi M. M. nuk kishte mundësi financiare për të likuiduar shumën e dhënë hua....nuk ka pasur në mënyrë absolute ndonjëherë ndonjë lloj konflikt interesi sa i takon përfshirjes së tij ose ndikimit të tij në ndonjë çështje ku M. M. ose familjarë të tij kanë qenë të përfshirë. Nuk ka gjykuar apo të ketë qenë pjesëmarrës si anëtar i trupit gjykues në mënyrë absolute asnjë çështje gjyqësore për të cilat shtetasi M. M. apo familjarë të tij mund të kenë pasur në gjykim.*

¹³ Shih, në dosjen e ILDKPKI-së, dokumentet i paraqitur nga subjekti.

¹⁴ Shih, në dosjen e ILDKPKI-së, dokumentet i paraqitur nga subjekti

¹⁵ Shih, shkresën e DPPPP-së, nr. (***) datë 10.05.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Shih, përgjigjet, datë 04.10.2018, për pyetësin nr. 2, në dosjen e Komisionit, përgjigjja e pyetjes 3 dhe dokumentet bashkëlidhur, dërguar me e-mail, më datë 17.10.2018.

4.3.b Për të vërtetuar deklarinimin se shtetasi M. M., ka ushtruar aktivitet tregtar, është verifikuar informacioni në faqen zyrtare të QKB-së, sipas të cilit¹⁷ ka rezultuar se ai ka ushtruar aktivitet tregtar të llojit “Kafene dhe Bar-Bufe” me NIPT (***) i regjistruar në vitin 1993 dhe i pezulluar në vitin 2012. Gjithashtu, ai ka qenë administrator i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “(***)” sh.p.k., me NIPT (***)¹⁸, themeluar në vitin 2012 dhe pezulluar në vitin 2017.

4.3.c Për të vërtetuar pretendimet lidhur me mosshqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës në gjykim të ketë qenë shtetasi M. M., u kërkua dhe u administrua vërtetimi, nr. (***) prot., datë 16.10.2018¹⁹, lëshuar nga kancelarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, sipas të cilit nuk rezulton që gjyqtari Izet Kadana të ketë gjykuar asnjë çështje që lidhet me shtetasin M. M.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushte të konfliktit të interesit me shtetasin M. M., dhe se deklarinimet e subjektit përputhen me dokumentet e administruara.

4.4. Lidhur me mundësinë për dhënien e huas:

Nga analiza financiare e kursimeve, pasqyruar në tabelën më poshtë, rezultoi se mundësia reale për të kursyer deri në fund të vitit 2013, ka qenë në shumën prej 6.483.709 lekësh, ndërkohë që subjekti ka deklaruar hua të dhënë në vitin 2014 në vlerën prej 7.000.000 lekësh.

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjendja e kursimeve CASH në fillim të periudhës të deklaruar	0	200,000	500,000	600,000	2,726,000	3,726,000	4,726,000	5,626,000	5,597,248	6,199,579	6,602,475
Gjendja e likuiditeteve në bankë në fillim të periudhës	0	730,108	873,906	1,553,221	57,730	181,005	16,806	34,137	-161,791	39,677	-164,363
Të ardhura	1,258,322	1,230,883	1,254,227	1,268,204	2,091,555	799,526	1,571,724	1,636,607	1,720,612	1,803,598	1,817,215
Shpenzime	642,857	642,857	642,857	642,857	658,233	662,955	642,857	1,371,610	900,526	1,089,961	642,857
Gjendja e kursimeve CASH në fund të periudhës të deklaruar	200,000	500,000	600,000	2,726,000	3,726,000	4,726,000	5,626,000	5,597,248	6,199,579	6,602,475	7,402,475
Gjendja e likuiditeteve në bankë në fund të periudhës	730,108	873,906	1,553,221	57,730	181,005	16,806	34,137	-161,791	39,677	-164,363	43,536
Aftësia / Mungesa e likuiditetit për kursime	-314,643	144,228	-167,945	-5,162	310,047	-699,231	11,536	489,677	16,287	514,781	166,459
Shtesa/pakësim i likuiditeteve çdo vit	930,108	443,798	779,315	630,509	1,123,275	835,801	917,331	-	803,798	198,856	1,007,899
Mundësia reale për të kursyer	615,465	443,798	611,370	625,347	1,123,275	136,570	917,331	-	803,798	198,856	1,007,899

Siç rezulton, subjekti nuk ka pasur mundësi për ti dhënë të gjithë shumën e huas në shumën prej 7.000.000 lekësh, shtetasit M. M. Deklarimet e tij lidhur me kursimet familjare ndër vite, si burim krijimi i kësaj huaje, kanë qenë të pasakta.

4.5. Barra e provës:

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua subjektit barra e provës në lidhje me pamundësinë financiare për të dhënë huanë në shumën prej 7.000.000 lekësh.

¹⁷ Shih, ekstraktin historik për të dhënat e subjektit M. M., në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shih, ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” të printuar nga faqja e QKB-së në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shih përgjigjet e pyetjeve shtesë të pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet bashkëlidhur, dërguar me e-mail, më datë 17.10.2018.

4.5.a. Në shpjegimet e tij²⁰, të datës 17.12.2018, subjekti pretendon se shuma prej 314.643 lekësh, për vitin 2003, i është konsideruar padrejtësisht e pajustificuar ligjërisht, duke shpjeguar se kjo shumë, është rrjedhojë e kursimeve para vitit 2003, dhe si e tillë, duhet të konsiderohet e ardhur e ligjshme. Ndërkohë, ai nuk ka paraqitur asnjë dokument shtesë nga ato të deklaruara për vitin 2003 dhe ato të administruara gjatë hetimit administrativ, për të vërtetuar pretendimin e tij. Gjatë analizës financiare janë marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat nga puna, të deklaruara dhe të dokumentuara të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si dhe deklaratimet e subjektit për kursimet familjare për këtë periudhë.

4.5.b. Gjithashtu subjekti pretendoi, se gjatë analizës financiare, nuk i është marrë në konsideratë shuma 139.086 lekë, dhe kjo ka ardhur për shkak se në vitin 2005 - 2006, është bërë një gabim nga punonjësja e “Raiffeisen Bank”. Për të vërtetuar këtë fakt, ka vënë në dispozicion informacion nga “Raiffeisen Bank”, mbi një sistemim veprimi që ka ndodhur në janar të vitit 2006 në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, znj. S. K. Pas verifikimit të këtij sistemimi, nga analiza financiare, rezultoi se nuk ndryshon shuma e likuiditeteve të pajustificuara në total për vitet 2005 dhe 2006, (- 173 107 lekë) por vetëm rezultatet përkatëse për këto vite. Konkretisht, diferenca ishte - 34,021 lekë për vitin 2005 dhe -139,086 lekë për vitin 2006. Pas rishikimit të analizës financiare, këto shuma u benë -167,945 lekë për vitin 2005 dhe -5,162 lekë për vitin 2006. Në total -173 107 lekë.

4.5.c. Për sa i përket likuiditetit të pajustificuar në shumën prej 699.231 lekësh për vitin 2008, subjekti pretendon se kjo diferencë, ka ardhur për shkak të një kredie të marrë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., për babain e saj të ndjerin H. M., dhe është shlyer nga ky person. Kjo kredi është përfshirë në analizën financiare të dërguar me rezultatet paraprake të hetimit, ndërkohë që sipas pretendimit të subjektit, kjo kredi nuk duhet të merrej në konsideratë.

Lidhur me këtë kredi, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, ka vlerësuar që ajo të përfshihet në analizën financiare, për shkak të arsyeve si në pikën 6 të këtij vendimi, “detyrime financiare”. Si rrjedhim pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me likuiditetin e pajustificuar në shumën prej 699.231 lekësh për vitin 2008, është i pabazuar.

Në përfundim u konstatua, se subjekti nuk paraqiti asnjë provë apo shpjegim bindës, për të vërtetuar te kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me huanë prej 7.000.000 lekësh, dhënë shtetasit M. M.

5. Hua e dhënë pa interes në shumën 1.400 000 lekë, me afat brenda 2 vitesh, shtetasit A. P., sipas deklaratës, datë 20.02.2015, vërtetuar me aktin noterial, nr. (*) rep., datë 01.12.2015. Burimi i deklaruar i krijimit, të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga pagat.**

5.1 Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

5.1.a. Sipas deklaratës së deklaruesit A. P., datë 20.02.2015, me vërtetim nënshkrimi nga noter D. M., shtetasi A. P., deklaroi se i ka marrë hua subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, shumën prej 1.400 000 lekësh, pa shpërblim, interes apo kamatë vonesë. Afati 2 vjet²¹.

5.1.b. Kjo shumë është raportuar pranë DPPPP-së nga noteri D.M.²²

²⁰ Shih, shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit të datës 17.12.2018, në dosjen e Komisionit.

²¹ Shih, në dosjen e ILDKPKI-së, dokument i paraqitur nga subjekti.

²² Shih, shkresën e DPPPP-së, nr. (***), datë 10.05.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

5.2. Nga deklaratimet periodike ndër vite, rezultoi se kjo hua është deklaruar:

5.2.a Në deklarinimin për vitin 2015: Dhënë hua pa interes në shumën 1.400 000 lekë me afat brenda 2 vitesh shtetasit A. P.

5.2.b Në deklarinimin për vitin 2016: Dhënë hua pa interes në shumën 1.400 000 lekë me afat brenda 2 vitesh shtetasit A. P.

5.2.c Në deklaratë “Vetting”, me po të njëjtat deklarime si në pikën 5 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime.

5.3 Lidhur me konfliktin e interesit me shtetasin A. P., i konsideruar si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 3 pika 14 të ligjit nr. 84/2016.

5.3.a. I pyetur në lidhje me marrëdhënien me këtë shtetas, arsyen e dhënies së huas pa interes, si dhe faktin nëse ka pasur çështje në shqyrtim me këtë shtetas, subjekti ka sqaruar ²³ se: “... me shtetasin A. P. kam lidhje shoqërore prej disa vitesh, dhe e kam komshi në pallat. Qëllimi i huas ka qenë për ta ndihmuar atë në biznesin e tij në qytetin e Pukës apo nevojat e tij familjare ... kjo shumë i është dhënë pa ndonjë shpërblim për shkak të lidhjeve shoqërore”. (Sqaron se tashmë kjo shumë i është kthyer).

Për të vërtetuar deklaratimet lidhur me aktivitetin tregtar të shtetasit A. P., nga ana e Komisionit, është verifikuar informacioni nga faqja zyrtare e nga QKB-së sipas të cilit ²⁴ ka rezultuar se shtetasi A. P., ka ushtruar aktivitet tregtar të llojit, “Tregti artikuj të ndryshëm kancelari”, me NIPT (***), i regjistruar në vitin 2010 dhe i pezulluar në vitin 2016. Gjithashtu ka rezultuar se deri në vitin 2017, ai ka qenë administrator i personit juridik “(***)” sh.p.k., i themeluar në vitin 2015 me NIPT (***).²⁵

5.3.b. Në lidhje me çështje objekt gjykimi që i përkasin huamarrësit A. P., në përgjigjet e datës 04.10.2018, subjekti deklaroi se *nuk ka pasur në mënyrë absolute ndonjëherë ndonjë lloj konflikt interesi sa i takon përfshirjes së tij ose ndikimit të tij në ndonjë çështje ku A. P. ose familjarë të tij kanë qenë të përfshirë. Nuk ka gjykuar apo të ketë qenë pjesëmarrës si anëtar i trupit gjykues në mënyrë absolute asnjë çështje gjyqësore për të cilat shtetasi A. P. apo familjarë të tij mund të kenë pasur në gjykim, për të cilën të jetë shprehur me një vendim gjyqësor përfundimtar.*

Për të vërtetuar pretendimet si më sipër, u kërkua dhe u administrua vërtetimi nr. (***) prot., datë 16.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë ²⁶, sipas të cilit gjyqtari Izet Kadana ka pasur një çështje ku shtetasi A. P. ka qenë palë në proces në cilësinë e të dëmtuarit akuzues, për të cilën është vendosur pushimi i gjykimit sipas vendimit nr. 34, datë 04.06.2013, dhe akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, nr. (***) regj., datë 07.05.2013. Gjithashtu, subjekti ka vënë në dispozicion kopje të njehsuar me origjinalin të dosjes penale nr. (***) të regjistrit themeltar, datë 07.05.2013, vendim

²³ Shih, përgjigjet e subjektit dërguar me *e-mail*, datë 04.10.2018, në dosjen e Komisionit, si dhe dokumentet bashkangjitur.

²⁴ Shih, ekstraktin historik për të dhënat e subjektit A. P., në dosjen e Komisionit.

²⁵ Shih, ekstrakt historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” të printuar nga faqja e QKB-së në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shih, dokumentet bashkangjitur ne përgjigje pyetjeve shtesë të Pyetësorit nr. 2, dërguar me *e-mail*, në datë 17.10.2018.

nr. 34, datë 04.06.2013, deklaratat e pajtimit të palëve të datës 04.06.2013, kopje të procesverbalit gjyqësor të datës 04.06.2013.

Nga dokumentet e administruara, rezultoi e vërtetuar se:

- Më datë 03.05.2013, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë është depozituar kërkesa për gjykim e të dëmtuarve akuzues: M. A. e A.P.j ndaj të akuzuarve: E. Rr. dhe E. Rr., me objekt: gjykimin e të akuzuarve për kryerjen e veprës penale të “Fyerjes”;
- Më datë 07.05.2013, është hedhur shorti nr. 58 për çështjen mes palëve i pandehur/i akuzuar: E. Rr., E. Rr. me të dëmtuar akuzues: E. A. dhe A. P. Ky short i ka rënë gjyqtarit Izet Kadana;
- Më datë 04.06.2013, është zhvilluar seanca gjyqësore;
- Me vendimin nr. 34, datë 04.06.2013, gjyqtari Izet Kadana për shkak të mosparaqitjes së palëve dhe për shkak të depozitimit të një kërkesë me shkrim për heqje dorë nga gjykimi, ka vendosur pushimin e gjyqimit të çështjes penale nr. (***) akti, datë 07.05.2013.

5.4. Në analizë të fakteve të grumbulluara lidhur me konfliktin e interesit me shtetasin A. P., Komisioni konstatoi se:

5.4.a. Në shpjegimet e datës 04.10.2018, subjekti nuk ka qenë i sigurtë, pasi ka deklaruar se nuk ka pasur çështje në shqyrtim me shtetasin A. P., duke mohuar realitetin e fakteve. Deklarimi se me këtë shtetas, nuk ka pasur çështje të gjykuara me vendim përfundimtar, nuk e shkarkon atë nga detyrimi për të dhënë sqarime të plota, pasi ai është pyetur në lidhje me çdo çështje në gjykim ku pjesëmarrës ka qenë shtetasi A. P., dhe jo vetëm për ato të zgjidhura me vendim përfundimtar. Veç të tjerash, vendimi i pushimit të një çështje gjyqësore nuk është një vendim i ndërmjetëm (brenda një çështje që do të vijonte), por është në vetvete një vendim përfundimtar. Edhe pse nuk ka pasur një dispozitiv për dhënie fajësie apo pafajësie, zgjidhja e çështjes në këtë fazë gjykimi, ka qenë definitive, pra përfundimtare.

5.4.b. Rastet e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi i një çështje dhe heqja dorë e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, janë të parashikuara nga nenet 72 (pika 6 parashikon “në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”) dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat e administruara, Komisioni vlerësoi se ka pasur rrethana dhe arsye serioze njëanshmërie për shqyrtimin e çështjes ku pjesëmarrës ka qenë shtetasi A. P. (edhe pse çështja nuk ka qenë me vendim themeli), dhe subjekti i rivlerësimit duhet të jepte dorëheqjen që në momentin që i është caktuar çështja për shqyrtim.

5.4.c. Pavarësisht vlerësimit si më sipër, Komisioni, iu drejtua organit kompetent për vlerësimin e konfliktit të interesit, ILDKPKI, dhe ky institucion ka konfirmuar konfliktin e interesit duke dhënë vlerësimin me shkrim²⁷, sipas të cilit gjyqtari Izet Kadana kishte detyrimin ligjor për deklarimin e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjes ku pjesëmarrës ka qenë shtetasi A. P. dhe për parandalimin e tij. Duke mos hequr dorë nga gjykimi i kësaj çështje gjyqësore, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesave dhe të papajtueshmërisë me funksionin e gjyqtarit në gjykim. Kjo rrethanë përbën një shkak për humbjen e besimit të publikut në figurën e gjyqtarit.

5.5. Lidhur me mundësinë për dhënien e huas:

²⁷ Shih shkresë kthim përgjigje Nr. (***) prot, datë 20.11.2018 nga ILDKPKI, në dosjen e Komisionit

Nga analiza financiare e kursimeve, pasqyruar në tabelën më poshtë, rezultoi se mundësia reale për të kursyer deri në fund të vitit 2014, ka qenë në shumën prej **986.836** lekësh, ndërkohë që subjekti ka deklaruar hua të dhënë në vitin 2015 në vlerën 1.400.000 lekë.

Përshkrimi	Viti 2014	
	Sipas deklarimeve viti 2014	Sipas mundësisë reale viti 2014
Gjendja e kursimeve CASH në fillim të periudhës të deklaruar	7,402,475	6,483,709
Gjendja e likuiditeteve në bankë në fillim të periudhës	43,536	43,536
Të ardhura	2,121,130	2,121,130
Dhënë hua shuma prej 7,000,000 lekësh	7,000,000	7,000,000
Shpenzime	642,857	642,857
Gjendja e kursimeve CASH në fund të periudhës të deklaruar	1,302,475	1,302,475
Gjendja e likuiditeteve në bankë në fund të periudhës	18,682	18,682
Aftësia / Mungesa e likuiditetit për kursime	603,127	-315,638
Shtesa/pakësim i likuiditeteve çdo vit	900,000	900,000
Mundësia reale për të kursyer	900,000	986,836

Pra subjekti nuk ka qenë në gjendje të japë të gjithë shumën e huas prej 1.400.000 lekësh shtetasit A. P. Ai ka qenë i pasaktë në deklaratimet për kursimet familjare, si burim krijimi i shumës së dhënë hua.

5.6. Barra e provës

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi e drejta për të paraqitur shpjegime e prova të reja për të vërtetuar të kundërtën.

5.6.a. Lidhur me konfliktin e interesit, në përgjigjet e datës 17.12.2018 ashtu sikurse dhe në seancën dëgjimore, subjekti pretendoi se *çështja në fjalë është pushuar me vendimin nr. 34, datë 04.06.2013, ndërkohë huaja është dhënë rreth dy vite më vonë shtetasit A. P...marrëdhëniet shoqërore me këtë shtetas, para momentit që ai ka shqyrtuar çështjen gjyqësore, nuk kanë qenë të tilla që ai të kishte detyrimin ligjor për të hequr dorë nga gjykimi i asaj çështjeje. Raportet e afërta shoqërore me shtetasin A. P. i ka krijuar pas vitit 2013, pra pas gjykimit të çështjes ku A. P. ishte palë në proces.*

Përveçse sa më sipër, ai ka këmbëngulur se *çështja nuk është gjykuar prej tij në themel me vendim përfundimtar, por është vendosur pushimi i gjykimit, për shkak të deklaratave për heqje dorë nga gjykimi i çështjes nga palët ndërgjyqëse si dhe për shkak të mos paraqitjes së tyre në gjykim.*

5.6.b Lidhur me mospasjen e mundësisë financiare për të dhënë huan në shumën prej 1.400.000 lekësh në vitin 2015 shtetasit A. P., subjekti ka pretenduar se *ka pasur të ardhura të ligjshme për justifikimin kursimeve për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2008 , të cilat nuk i janë marrë në konsideratë, dhe si rrjedhojë e kësaj, ka pasur mundësi reale financiare, për të dhënë huan te shtetasi A. P.*

Arsyetim:

Në analizë të fakteve dhe rrethanave, edhe pas parashtrimeve të subjektit, në përfundim, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin A. P., si dhe ai nuk ka pasur mundësi financiare të mjaftueshme për dhënien e të gjithë shumës së huas së deklaruar këtij shtetasi, për shkak se:

- Subjekti ka deklaruar në përgjigjet, më datë 04.10.2018, se ka pasur marrëdhënie shoqërore prej disa vitesh me shtetasin A. P., me të cilin ka qenë komshi në të njëjtin pallat, pa përcaktuar periudhën. Pikërisht kjo marrëdhënie, ka qenë shkak për dhënien e huas pa interes, më datë 20.02.2015. Në parashtrimet e tij të mëvonshme, pas kalimit të barrës së provës si dhe në seancë dëgjimore, ai nuk vërtetoi me asnjë provë pretendimin se marrëdhëniet shoqërore me shtetasin A. P., kanë filluar pas datës 04.06.2013 (kur është zhvilluar seanca gjyqësore).

- Subjekti ka qenë i pasinqertë në deklaratimet e tij të datës 04.10.2018, pasi nuk ka deklaruar çështjen penale, ku palë pjesëmarrëse në gjykim ka qenë shtetasi A. P. Vihet re, se ai ka anashkaluar përgjigjen e saktë dhe të plotë të pyetjes nëse ka pasur çështje në shqyrtim ku palë pjesëmarrëse ka qenë shtetasi A. P., duke sqaruar se nuk ka gjykuar çështje me vendim përfundimtar me këtë shtetas, ndërkohe që kërkesa nga ana e Komisionit, i është bërë për çfarëdo lloj çështje. Kjo gjë që tregon në mënyre indirekte, se ai ka qenë plotësisht i ndërgjegjshëm për konfliktin e interesit me shtetasin A. P., dhe për këtë shkak e ka mohuar ekzistencën e një çështje të cilën ai e kishte shqyrtuar dhe kishte një vendim pushimi për të. Pushimi i gjykimit të çështjes, nuk e shkarkon subjektin e rivlerësimit nga përgjegjësia për mosdhënie të dorëheqjes nga shqyrtimi i çështjes, që në momentin që ajo i është caktuar për shqyrtim.

- Dhënia e huas pa interes, më datë 20.02.2015, dëshmon për një marrëdhënie të fortë miqësie midis tyre.

- Lidhur me të ardhura të pretenduara për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2008, subjekti nuk paraqiti asnjë provë të re për të vërtetuar të ardhura të tjera përveç atyre të deklaruara. Pas pretendimeve të tij, u rishikua analiza financiare, dhe rezultoi se subjekti nuk ka pasur kursime të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën prej 1.400.000 lekësh shtetasit A. P.

Në përfundim u konstatua, se subjekti nuk paraqiti asnjë provë apo shpjegim bindës, për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me huanë prej 1.400.000 lekësh dhënë shtetasit A. P., si dhe në lidhje me konfliktin e interesit me këtë shtetas.

6. Detyrime financiare

Kredi bankare e marrë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., sipas kontratës datë 27.08.2007, në vlerën 700.000 lekë, me afat 24 muaj, me huadhënës "Raiffeisen Bank", me interes

7% në vit. Kredia është deklaruar si kredi e marrë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., si punonjëse e “Raiffeisen Bank”, dega Pukë, me qëllim për të ndihmuar biznesin e babait të saj, të ndjerit H.S.M.. Është deklaruar shlyerja e saj, para afatit në kontratë nga i ndjeri H. S. M., më datë 28.03.2008.

Pavarësisht se kjo kredi është shlyer në vitin 2008, dhe subjekti nuk ka pasur detyrimin ta deklaronte në deklaratën “Vetting”, Komisioni, ka kryer disa veprime hetimore për të zbardhur çdo paqartësi lidhur me këtë kredi, si dhe për të vlerësuar marrjen në konsideratë ose jo të saj, gjatë analizës financiare.

6.1. Nga hetimi administrativ, u konstatua se:

“Raiffeisen Bank”²⁸ konfirmon se znj. S. K. ka qenë kredimarrëse pranë kësaj banke për një kredi të marrë, më datë 27.08.2007, në shumën 700.000 lekë, dhe më datë 28.03.2008 ka bërë mbylljen e kredisë.

6.2 Nga deklaratimet ndër vite, ka rezultuar se kjo kredi është deklaruar:

6.2.a. Në deklarinimin për vitin 2007, si kredi bankare marrë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 700.000 lekë, me interes 7%, më datë 27.08.2007, me afat 2 vjet, dhe bashkë me interesat shkon në vlerën 752.179 lekë. Kredia është marrë nga bashkëshortja e subjektit, znj. S. K., me qëllim për të ndihmuar biznesin e babait të saj H. M. dhe që shlyhet rregullisht në mirëbesim prej tyre.

6.2.b. Në deklaratën “Vetting” është deklaruar me të njëjtat deklarime, si dhe është shprehur fakti që kredia është shlyer më datë 28.03.2008.

Nuk janë konstatuar pasaktësi në deklarime.

Lidhur me deklarinimin se kredia është marrë për babain e bashkëshortes së subjektit, me qëllim për ta ndihmuar në aktivitetin e tij tregtar, ai deklaroi²⁹ se : ... *aktiviteti i ushtruar prej tij ka qenë “furrë buke” që nga viti 1994 e në vazhdim, ku sot ky aktivitet ushtrohet nga L. M. e cila është bashkëshortja e djalit të tij të quajtur B. M., me NIPT (***)*, në qendër të qytetit Pukë. Bashkëngjitur, ka dërguar kopje të certifikatës së regjistrimit pranë QKR-së, më datë 20.02.1995 dhe datë lëshimi 26.10.2012.

Lidhur me faktin e marrjes së kredisë në vlerën 700.000 lekë, me interes 7%, në vitin 2007 për të ndihmuar vjehrrin, ndërkohë që ai dhe bashkëshortja kanë pasur mjaftueshëm kursime familjare gjatë vitit 2007 kur është marrë kredia, subjekti sqaron se... *nuk i është kërkuar të japë hua nga paratë e tij të kursyera, dhe se kredia është marrë nga bashkëshortja e tij si punonjëse e bankës me iniciativën e vet me marrëveshje me babain e saj... ai thjesht ka dhënë pëlqimin.*

Me qëllim verifikimi, i është kërkuar informacion QKB-së, e cila informon³⁰, se shtetasi H. S. M., i datëlindjes 1933, figuron ortak i vetëm dhe administrator në shoqërinë “(***)” sh.p.k., regjistruar

²⁸ Shih, shkresën e “Raiffeisen Bank”, nr. (***) prot., datë 10.04.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shih, përgjigjet e pyetësorit shtesë, të datës 02.11.2018, dërguar subjektit, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Shih, shkresën kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 14.11.2018, nga QKB në dosjen e Komisionit.

me vendimin, nr. 15521, datë 25.07.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kohëzgjatje mbi 10 vjet , aktivitet i vijuar nga nusja e djalit të H. M., znj. L. M.

Në shpjegimet e tij të datës 17.12.2018, subjekti ka deklaruar *se kredia i ishte dhëne nga banka bashkëshortes së tij dhe çdo dokument ishte firmosur prej saj, por de facto, kredia ishte marrë për babain e saj, të ndjerin H. M. dhe çdo kështu në kthimin dhe likuidimin e kësaj kredie, është paguar prej tij, dhe në çdo rast, bashkëshortes se subjektit i janë dhëne kështu e radhës dorazi, ku dhe kështu bankare i janë mbajtur nga llogaria e saj bankare, duke bërë edhe mbylljen e saj kredie*. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka vënë në dispozicion dy deklarata noteriale nga bashkëshortja e të ndjerit H. M., Z. M. dhe djali i të ndjerit, B. M.³¹ .

Lidhur me marrjen e kredisë me qëllim për të ndihmuar babanë e bashkëshortes në aktivitetin e tij, mbetet e paqartë se përse znj. S. K. mori kredi, ndërkohe që ajo dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mjaftueshëm kursime familjare për ti dhënë të ndjerit H. M. shumën prej 700.000 lekësh. Por, Komisioni, duke mbajtur parasysh se ky fakt është deklaruar nga subjekti që në deklarin periodik për vitin 2007, nuk e konsideroi këtë si deklarin të rremë në deklarin për “Vetting”.

Lidhur me kredinë prej 700.000 lekë, rezultoi e vërtetuar se:

- Nuk ka asnjë dokument bankar që të vërtetoje kalimin e shumës prej 700.000 lekësh në llogari të të ndjerit H. M., pasi u disbursua kredia në emër të znj. S. K.
- Nuk ka asnjë dokument shkresor që të vërtetojë shumat përkatëse të kësteve duke përfshirë dhe interesat, si dhe dhënien e tyre dorazi ose në rrugë bankare, nga ana e z. H. M., znj. S. K.
- Subjekti nuk ka deklaruar në asnjë moment në deklarinet periodike për vitet 2007 dhe 2008, të ardhura të përfituara nga babai i bashkëshortes, me qëllim shlyerjen e kësteve të kredisë.
- Në deklarin për vitin 2007, subjekti është shprehur që kredia shlyhet rregullisht në mirëbesim prej tyre, pa përcaktuar mënyrën e shlyerjes.
- Deklaratat noteriale të bashkëshortes dhe djalit të të ndjerit H. M. të redaktuara në muajin dhjetor 2018, të vëna në dispozicion nga subjekti, për të vërtetuar pretendimet e tij lidhur me marrjen dhe shlyerjen e kredisë, nuk merren në konsideratë nga ana e Komisionit, duke u çmuar si akte deklarative në tentativë për të dhënë një mbështetje të pretendimeve aktuale të subjektit, dhe jo si dokumenta shkresorë ligjorë të periudhës kur kanë ndodhur faktet, dhe që vërtetojnë pretendimet e tij.

Si përfundim, kredia prej 700.000 lekësh, e marrë ligjërisht prej znj. S. K., dhe u shlyer prej saj përpara afatit të përcaktuar në kontratë, është vlerësuar të merret në konsideratë gjatë analizës financiare.

ANALIZA FINANCIARE

Gjate hetimit administrativ, është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore.

³¹ Shih, dokumentet bashkangjitur me shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit të datës 17.12.2018, në dosjen e Komisionit.

Nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 - 2016, pasqyruar në mënyre të përmbledhur në tabelën më poshtë, rezulton që subjekti ka pasur likuiditet të pajustificuar në total në shumën prej 1.186.981 lekësh.

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	1,258,322	1,230,883	1,254,227	1,268,204	1,501,543	1,389,538	1,571,724	1,636,607	1,720,612	1,803,598	1,817,215	2,121,130	2,347,265	2,549,310
Pasuri neto	930,108	443,798	779,315	630,509	533,263	1,425,814	917,331	504,072	803,798	645,960	1,007,899	875,146	744,723	271,254
Shpenzimet	642,857	642,857	642,857	642,857	658,233	662,955	642,857	642,857	900,526	642,857	642,857	642,857	642,857	927,401
Pasuri neto + Shpenzime	1,572,965	1,086,655	1,422,172	1,273,366	1,191,496	2,088,769	1,560,188	1,146,930	1,704,325	1,288,817	1,650,756	1,518,003	1,387,581	1,198,655
Të ardhura - (Pasuri Neto + Shpenzime)	-314,643	144,228	-167,945	-5,162	310,047	-699,231	11,536	489,677	16,287	514,781	166,459	603,127	959,684	1,350,655

Metodologjia e përdorur nga Komisioni, gjatë analizës financiare:

Gjatë analizës financiare, Komisioni, është bazuar në :

1. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga “Raiffeisen Bank”³², “Raiffeisen Invest”³³, nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” – Old Statement ³⁴ si dhe të gjendjes *cash* në fund të çdo viti të deklaruar nga subjekti ³⁵.

2. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në Shkollën e Mesme Pukë³⁶, të ardhurat nga pagat e subjektit në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër ³⁷, të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës³⁸, të ardhura nga pagat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë³⁹.

(ii) Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit në Këshillin e Rrethit Pukë⁴⁰, të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit në Degën e Bankës së Kursimit Pukë më pas u bë “Raiffeisen Bank”⁴¹, të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë⁴².

3. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në llogaritjet e ILDKPKI-së.⁴³

(ii) Shpenzime shkollimi të djalit bazuar në përgjigje të pyetësorit subjektit.⁴⁴

³² Shih, shkresën nr. (***) , datë 10.04.2018, në dosjen e Komisionit.

³³ Shih shkresën nr. (***) , datë 12.4.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shih nxjerrjet e llogarive nga “Raiffeisen Bank” - Old Statement dhe librezën e depozitës fleksibile në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Shih deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶ Shih vërtetimin nr. (***) prot., datë 31.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁷ Shih vërtetimin nr. (***) prot., kopje nr. 2, datë 13.12.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸ Shih vërtetimin nr. (***) prot., datë 20.10.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹ Shih vërtetimin nr(***)prot., datë 09.01.2016, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁰ Shih vërtetimin nr. (***)prot., datë 12.10.2016 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Shih vërtetimin nr. (***) prot., datë 12.10.2016 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴² Shih vërtetimin nr(***)prot., S. K, datë 25.01.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³ Shih raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, fq.10.

⁴⁴ Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 02.11.2018

4. Detyrimet lidhur me huat e dhëna nga subjekti i rivlerësimit të tretëve.⁴⁵
5. Principalin dhe interesat e paguara për kredinë nga dokumentet e ardhura nga “Raiffeisen Bank”⁴⁶.
6. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive.⁴⁷

Rezultatet përfundimtare në lidhje me rivlerësimin e pasurisë :

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me rivlerësimin e pasurisë, sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana, ka rezultuar se:

- Ka deklarime të pasakta lidhur me burimin e të ardhurave për dhënien e dy huave, sipas nenit 33, pika 5, gërma a ;
- Ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar likuiditetin në shumën prej 1.186.981 lekësh, sipas nenit 33, pika 5, gërma b;
- Subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, sipas nenit 33, pika 5, gërma d.

II.2. VLERËSIMI I FIGURËS

II.2.a Vlerësimi nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK):

Ky institucion, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2006. Për këtë qëllim, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. (***)prot., datë 02.11.2017, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit për të vijuar ushtrimin e detyrës. Bashkangjitur këtij raporti janë vënë në dispozicion dokumentet si vijojnë :

1. Deklaratë për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, shtojca 3, më datë 28.01.2017 ku rezulton që subjekti të ketë deklaruar faktin se nipi i tij, z. Sh. R. K., është akuzuar për trafikim lëndësh narkotike në Itali dhe se ai së bashku me vëllain e tij, z. R. K., janë akuzuar në Shqipëri për veprën penale të “pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (vepër e përfshire në krimin e organizuar).
2. Shkresë nr. (***)prot., datë 12.10.2017, të “SHÇBA”-së, ku rezulton se subjekti dhe familjarët e tij nuk figurojnë të regjistruar për veprimtari kriminale.

⁴⁵ Shih deklaratën e z. M. M., datë 03.04.2014, shoqëruar me vërtetimin nënshkrimi, nr. (***) rep., datë 17.09.2014; shih deklaratën e z. A. P., datë 20.02.2015, shoqëruar me vërtetimin nënshkrimi, nr. (***) rep., datë 01.12.2015; përgjigjet e pyetësorit të datës 02.11.2018, shih përgjigjet e pyetësorit të datës 10.10.2018, shih përgjigjet e pyetësorit të datës 04.10.2018.

⁴⁶ Shih shkresën nr. (***) , datë 10.04.2018, në dosjen e Komisionit, në dosjen e Komisionit dhe kontratën e kredisë bankare në dosjen e ILDKPKI-së datë 24.08.2007.

⁴⁷ Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme bashkëngjitur shkresës së ZVRPP-së Pukë me nr. (***) prot., datë 27.09.2018, akti i shitblerjes nga noteria pukë, nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.12.1995, në dosjen e ILDKPKI-së, përgjigjet e pyetësorit të datës 04.10.2018 si dhe kontratat e shitjeve të automjeteve bashkëngjitur shkresave të DPSHTRR-së Tiranë me nr. (***)prot., datë 26.4.2018, në dosjen e Komisionit.

3. Shkresë nr. (***)prot., datë 04.10.2017, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku rezulton se në ngarkim të shtetasit Izet A. Kadana, nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal.

4. Shkresë nr. (***) prot., datë 09.11.2017, të “SHISH”-it, e cila përmban të dhëna konfidenciale të vitit 2010 dhe 2015, në lidhje me shtetasit R. A. K. (i vëllai) dhe djemtë e tij Sh. dhe I. K., si dhe dy nipërit e tjerë të subjektit K. dhe A. K., (djemtë e S. K., vëllai tjetër i subjektit të rivlerësimit, Izet Kadana).

5. Certifikatë e gjendjes familjare të subjektit të rivlerësimit me datë lëshimi 20.09.2017.

II.2.b Hetimi administrativ gjatë procesit të rivlerësimit të figurës nga Komisioni:

Ky hetim konsistoi në:

a. Verifikimin e faktit nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi në bazë të nenit 39 pika 2.

b. Verifikimin nëse ka informacione që tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në bazë të nenit 39 pika 2.

c. Konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës, me qëllim vërtetimin e faktit nëse subjekti ka bërë deklarament të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës sipas parashikimit të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 39 të këtij ligji.

Për shkak të të dhënave të grumbulluara në fazën paraprake të hetimit, sipas të dhënave konfidenciale të “SHISH”-it, dhe deklaramenteve të subjektit në përgjigje të pyetësorit të parë (lidhur me qëndrimin e djalit të tij në banesën e vëllait R. K.), u kërkua rishikimi i figurës nga ana e DSIK-së⁴⁸ për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana.

Gjatë procesit të rivlerësimit të figurës për z. Izet Kadana, janë kërkuar dhe administruar informacionet e vërtetuara me dokumente shkresore ligjore si vijojnë:

1. Pas kërkesës për rishikimin e raportit, DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit informacione shtesë si vijon :

1.1 Shkresën nr. (***) prot., datë 11.06.2018, të SHISH-it, ku përcillet një informacion më i detajuar (konfidencial) në lidhje me z. R. K. dhe djemtë e tij Sh., I. dhe F. K. si dhe në lidhje me A. e K. K., të bijtë e S. K.(vëllai tjetër i subjektit të rivlerësimit).

1.2 Shkresën nr. (***)prot., datë 12.05.2018, të SHÇBA-së, me të cilën vërtetohet se R.A.K., I. R. K., K.S. K., dhe A. S. K., nuk figurojnë të regjistruar për veprimtari kriminale, ndërsa shtetasi Sh. K., figuron me precedent kriminal në Shqipëri dhe se ky shtetas ka qenë i burgosur në shtetin Italian.

⁴⁸ Shih, shkresë nr. (***) prot, datë 02.11.2018, drejtuar DSIK-së në dosjen e Komisionit.

1.3 Shkresën nr(***)prot., datë 28.06.2018, të SHÇBA-së, e cila pas verifikimeve të mëtejshme, konfirmon se shtetasi Sh. R. K., është i evidentuar si person me precedent kriminal dhe në ngarkim të tij janë referuar materialet për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Për shtetasin K. K. rezulton që të jetë dënuar për falsifikim të dokumenteve, sipas nenit 186/1 i Kodit Penal. Për shtetasin A. S. K., rezulton të jetë shoqëruar në polici pasi ngiste me shpejtësi automjetin.

1.4 Vendim nr. 88, datë 01.02.2012, sipas të cilit K. S. K., është dënuar për veprën penale falsifikim të dokumenteve zyrtare parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal (vepër që nuk përfshihet në krimin e organizuar).

2. Pas kërkimit të të dhënave lidhur me vendimin e pushimit të çështjes penale parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve Sh. e R. K., Prokuroria e Përgjithshme, vuri në dispozicion vendimin për pushimin e çështjes penale të datës 28.02.2014, sipas të cilit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka regjistruar çështjen nr. (***) , datë 01.03.2012, në ngarkim të shtetasve Sh. e R. K., për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (vepër e përfshire në veprat e krimit të organizuar), mbi bazën e materialit të referuar nga Oficerët e Policisë Gjyqësore të sektorit kundër krimit financiar, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, ka pushuar çështjen penale nr. (***) , datë 01.03.2012.

3. Pas kërkimit të të dhënave për shtetasit R. e I. K., Drejtoria e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. (***) prot., datë 12.10.2018, konfirmoi se këta shtetas nuk rezultojnë të regjistruar për veprimtari kriminale.

4. I janë kërkuar të dhëna Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shtetasit Sh. R. K., R. A. K., I. R. K. (i njohur edhe si I. R. L., A. R. K., A. R. L., pasi ka ndryshuar emrin), K. S. K., A.S. K. dhe F. R. K., prej të cilave është marrë informacion si vijon:

4.1 Ndaj shtetasve R. A. K. dhe I. R. L. (K.), etj nuk rezulton të ketë filluar procedim penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë⁴⁹.

4.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ⁵⁰ informon se :

- Për shtetasin R. K. është regjistruar kallëzimi penal, nr. (***) , për veprën penale të parashikuar nga neni 186/2,3 i Kodit Penal(falsifikim i dokumenteve, vepër që nuk përfshihet në krimin e organizuar), për të cilin, më datë 18.02.201, është vendosur mosfillimi i hetimeve.

- Për shtetasit Sh. dhe F. K. është regjistruar kallëzimi penal, nr. (***) , për veprat penale të parashikuara nga nenet 277 (vetëgjyqësia) dhe 90/2 (dëmtime të tjera me dashje) të Kodit Penal (nuk përfshihen në krimin e organizuar) për të cilin, më datë 26.12.2011, është vendosur mosfillimi i hetimeve.

- Për shtetasin I. K. është regjistruar kallëzimi penal, nr. (***) , për veprën penale të “Mashttrimit”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal (nuk përfshihet në krimin e organizuar) për të cilin, më datë 20.05.2011, është vendosur mosfillimi i hetimeve.

⁴⁹ Shih shkresën kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 12.10.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Shih shkresën kthim përgjigje, nr. (***) prot, datë 07.11.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, në dosjen e Komisionit.

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në shkresën e saj drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme⁵¹, informon se ndaj shtetasit Izet Kadana:

- Është regjistruar kallëzimi, nr. (***) , viti 2016, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi;

- Janë kryer hetime në kuadër të procedimit penal, nr. (***) , viti 2016, për të cilin është vendosur pushim i çështjes më datë 20.03.2017.

6. Prokuroria e Përgjithshme⁵² përcjell informacionin e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda si dhe nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për shtetasit R.A.K.dhe I. R. K. (L.), sipas të cilave rezulton se për këta shtetas nuk ka çështje penale apo kallëzime penale të filluara ndaj tyre.

7. I janë kërkuar të dhëna DPPP, për raportime në lidhje me shtetasit R. A. K., I. R. K., Sh. R. K., K. S. K. dhe A. S. K.

DPPP me shkresën nr. (***) prot, datë 06.11.2018, informon se për shtetasit R. A. K. dhe K. S. K. rezultojnë raportime të transaksioneve bankare në shuma të konsiderueshme dhe kontrata noteriale të këtyre subjekteve.⁵³

8. Janë kërkuar të dhëna në shtetin Italjan për shtetasin I. R. K., I. R. L., A. R. K., A. R. L., për të cilët nga informacioni i siguruar nuk ka rezultuar të jenë përfshirë në vepra penale të krimit të organizuar, por I. R. K., është dënuar për dy vepra të tjera penale.

9. DSIK-ja me shkresën nr. (***) prot., datë 09.11.2018, DSIK ka dërguar raportin për rishikimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku konstaton papërshtatshmërinë për vijimin e detyrësi nga ana e tij, i deklasifikuar me shkresën nr. (***) prot., datë 12.11.2018, raport i cili është deklasifikuar pjesërisht.

Arsyetim ligjor në lidhje me papërshtatshmërinë e subjektit për vijimin e detyrës:

A. Lidhur me formularin për kontrollin e figurës:

Formulari për kontrollin e figurës është plotësuar me saktësi e vërtetësi nga ana e subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, lidhur me nipin Sh. R. K. dhe vëllain R. A. K., pasi ai ka deklaruar duke dhënë sqarime për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar, për shkak të procedimit penal

⁵¹ Shih shkresën nr. (***)prot., datë 02.10.2018. të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme

⁵² Shih shkresën kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 22.11.2018. nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

⁵³ Shih shkresën kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 06.11.2018. nga DPPP-së në dosjen e Komisionit : Banka Kombëtare e Greqisë, vlera e transaksionit 11.042.725.00 lekë, datë 21.07.2011, Banka Kombëtare e Greqisë, vlera e transaksionit 2.376.255.00 lekë, datë 21.07.2011, Banka Kombëtare e Greqisë vlera e transaksionit 10.365.399.08 lekë, datë 22.07.2011, Banka Kombëtare e Greqisë, vlera e transaksionit 20.000.000 euro, datë 09.06.2009, Banka Kombëtare e Greqisë, vlera e transaksionit 5.000.000,00 lekë, datë 15.07.2009. Transaksione me vlera mbi 1.5 milion lekë në para fizike, shitje toke bujqësore, me sip. 2500 m², vlera 2.250.000,00 lekë..

sipas nenit 287 të Kodit Penal. Gjithashtu subjekti ka deklaruar kontaktin me vëllain R. K. (Sh. K. rezultoi në vdekje në kohën e mbushjes së formularit).

Ndërkohë, konstatimi i DSIK, se ka rrethana (sipas kriterit të përcaktuar në germa a dhe b të pikës 6 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016) që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, nuk është i bazuar, pasi vepra penale “*Falsifikim i dokumenteve*” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për të cilën është dënuar nipi K. K., (fakt të cilit i referohet DSIK), nuk përfshihet në veprat penale të krimit të organizuar.

B. Lidhur me kontaktin e papërshtatshëm me personat e lidhur të përfshirë në krimin e organizuar:

Nga hetimi administrativ, rezultoi se Sh. R. K. (nipi), R. A. K. (vëllai), janë proceduar penalisht në çështjen, nr. (***) , datë 01.03.2012, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, veprë e përfshirë në veprat e krimit të organizuar sipas nenit 3, pika 15, të ligjit nr. 84/2016. Organi i akuzës ka pushuar çështjen penale, nr. (***) , datë 01.03.2012.

Neni 38, pika 4, i ligjit nr. 84/2016, parashikon rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Germa ç, e kësaj dispozite ligjore, parashikon veç të tjerave, se një nga rastet për konstatimin e kontakteve të papërshtatshme, është kur subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar.

Në referim të kësaj dispozite, konstatohet se ekziston kontakt i papërshtatshëm midis subjektit dhe vëllait të tij, shtetasit R. K., për shkak se:

- a. Lidhja gjinore midis vëllezërve, është një lidhje e ngushtë.
- b. Subjekti në formularin për kontrollin e figurës ka deklaruar se kontakton me vëllain e tij z. R. K.
- c. Në përgjigjet e pyetësorit të parë dërguar Komisionit nga ana e subjektit, në datën 03.05.2018, ai ka deklaruar se djali i tij E. K., i cili vazhdon studimet në Tiranë, qëndron edhe në shtëpinë e vëllait të tij R. K., gjatë kohës së studimeve, të cilat kanë filluar që nga viti 2016.
- d. Edhe pse subjekti e ka deklaruar kontaktin me vëllain e tij R. K., gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës (gjë e cila është konsideruar si rrethanë lehtësuese nga ana e DSIK-së), nga hetimi administrativ nuk vërtetohet se marrëdhënia e subjektit me shtetasin R. K. është e largët ose ka kontakte familjare të rralla (germa b, pika 5, të nenit 38). Gjithashtu, nuk vërtetohet që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë apo të jetë i distancuar prej tij. Përkundrazi, me deklaratimet e tij (pas kalimit të barrës së provës dhe në seancën dëgjimore) u vërtetua një marrëdhënie e ngushtë dhe kontakt në vijimësi midis tyre (germa c dhe ç e pikës 5 të nenit 38).

Në përfundim, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të sipërpërmendura, Komisioni ka konstatuar se subjekti është në kushtet e kontaktit të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, ashtu si ka konstatuar dhe institucioni kompetent për vlerësimin e figurës, DSIK.

C. Lidhur me konstatimin e faktit se subjekti mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale:

Pika 1 e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, parashikon se kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale dhe informacione të disponueshme.

Bazuar në prova të sakta (vendim pushimi në ngarkim të R. e Sh. K. për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal) dhe në informacione konfidenciale të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me vëllain e subjektit, z. R. K. dhe pesë nipërit e tij, për përfshirjen e tyre në veprimtari të krimit të organizuar, Komisioni çmoi se ka rrethana të tilla që të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit, mund të vihet lehtësisht nën presion nga struktura kriminale, ashtu sikurse ka konstatuar DSIK-ja, sipas parashikimit të nenit 37, pika c, të ligjit nr. 84/2016.

Ndërkohë, procedimet penale të nipërve të subjektit, I.R. K., Sh. R. K., K. S. K. dhe A. S.K., për vepra penale që nuk përfshihen në veprimtari të krimit të organizuar, edhe pse nuk përbejnë shkak ligjor për vlerësim negativ të figurës së subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, dhe si rrjedhim për shkarkimin e tij nga detyra, janë marrë në konsideratë nga Komisioni, në vlerësim të përgjithshëm të rrethanave, duke i konsideruar ato si shkaqe që ndikojnë në cenimin e besimit të publikut të subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

10. Barra e provës:

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua subjektit barra e provës, lidhur me konstatimet në lidhje me figurën.

10.1 Për sa i përket lidhjes së ngushtë me vëllain R. K., subjekti gjatë parashtrimeve, me datë 17.12.2018, si dhe në seancën dëgjimore, deklaroi se u qëndron shpjegimeve të dhëna për çështjen penale të hapur ndaj tij, të pushuar me vendimin e datës 28.02.2014 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, shtoi se gjatë viteve 2016 - 2017, ka pasur kontakte të vazhdueshme për arsye familjare, pasi në janar 2017 ka ndërruar jetë nipi i tij Sh. K., dhe pas vdekjes së tij, më datë 09.11.2017, ka vdekur dhe bashkëshortja e vëllait të tij B. K. Po kështu, ai përmendi se vëllai i tij, R. K., ka pasur dhe vijon të ketë probleme shëndetësore me zemrën. Në këtë mënyrë, subjekti konfirmoi lidhjen e ngushtë mes tyre dhe se vazhdon të jetë në kontakte me të, duke shkuar edhe në shtëpinë e tij.

Për vërtetimin e rrethanave të mësipërme, subjekti ka vënë në dispozicion dokumente mjekësore lidhur me sëmundjen dhe vdekjen e kumatës së tij, znj. B. K.⁵⁴.

10.2 Lidhur me qëndrimin e djalit në shtëpinë e vëllait të tij, në shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit, të datës 17.12.2018, si dhe gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se *ka pasur raste që djali i tij E. K., ka shkuar në shtëpinë e vëllait të tij R. K., vetëm gjatë kohës që bashkëshortja e këtij të fundit, zonja B. K. ka qenë e sëmure dhe kishte nevojë për përkujdesje, dhe vetëm për këtë shkak.*

⁵⁴ Shih, dokumentet bashkangjitur me shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit të datës 17.12.2018, në dosjen e Komisionit.

Ndërkohë, në përgjigjet e pyetësorit të parë standard, ai është shprehur se... *djali im E. K. qëndron (qëndron nëse konsiderohet përdorim gjatë kohës që është në shkollë, në UET Tiranë) tek vëllezërit e mi, me familjarët e tyre, R. K. dhe E.K.*⁵⁵.

Shihet qartë se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e tij pasi iu kalua barra e provës si dhe në seancë dëgjimore, dhe duke ndryshuar qëndrimin e mbajtur në përgjigje të pyetësorit të parë standard, është përpjekur të justifikojë qëndrimin e djalit të tij në shtëpinë e vëllait R. K., për shkak të sëmundjes së bashkëshortes së tij. Në këtë mënyrë ai ka mohuar deklaratimin e parë të tij, ku ka pranuar se gjatë vazhdimin të studimeve në Tiranë, djali i tij përdor edhe banesën e vëllait të tij R. K.

10.3. Për sa i përket kontakteve me nipërit e tjerë:

- Për nipin, Sh. R. K., subjekti i qëndroi shpjegimeve të dhëna në formularin për kontrollin e figurës.
- Në lidhje me nipin, I.R. K., subjekti deklaroi se ai jeton në Shqipëri dhe se ka kontakte të rralla nëpërmjet telefonit, dhe vetëm për arsye familjare duke pretenduar se nuk ka informacion që të jetë marrë me aktivitet kriminal.
- Në lidhje me nipin, F. R. K., deklaroi se jeton në Romë, Itali, dhe pretendoi se ka kontaktuar me të vetëm në rastin e vdekjes së vëllait dhe nënës së tij.
- Në lidhje me nipin, K. S.K., deklaroi jeton në Shqipëri dhe se nuk ka informacion që të jetë marrë me aktivitet kriminal. Është takuar vetëm në rastin e dasmës së motrës së tij, dhe vdekjeve të sipërcituara.
- Në lidhje me nipin A. K., deklaroi se ai jeton në Angli dhe nuk ka kontakte me të prej më shumë se 10 vitesh.

Pretendimet e subjektit në lidhje me marrëdhëniet me nipërit e sipërpërmendur, janë marrë në konsideratë nga ana e Komisionit, gjatë procesit të rivlerësimit të figurës.

Në përfundim, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të vena në dispozicion me rezultatet paraprake të hetimit, lidhur me vlerësimin e figurës.

Rezultatet e rivlerësimit të figurës:

Në përfundim, sipas nenit DH, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, krijoi bindjen, bazuar në prova dhe në ligj, se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, është i papërshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

II.3. VLERËSIMI PROFESIONAL

Me shkresën e KLD-së, nr. (***) prot., datë 17.07.2017, IKLD-ja ka dërguar pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana.

Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana. Ky rivlerësim është bazuar në:

⁵⁵ Shih, përgjigjen e pyetësorit të parë dërguar nga subjekti, më datë 03.05.2018, në dosjen e Komisionit.

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së, dërguar me shkresën, nr. (***) prot., datë 17.07.2017.
- Informacionin e marr nga burime të ligjshme. Si i tillë është konsideruar informacioni i marr nga tre denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit Izet Kadana, pranë KLD-së sipas shkresës kthim përgjigje, nr. (***) prot., datë 31.10.2018, nga KLD-ja.
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Raporti për analizën dhe aftësi profesionale kryer nga Inspektorati i KLD-së është bazuar:

- Formularin e vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjerë që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- Pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Nga analiza e Inspektoratit të KLD-së⁵⁶, është bërë vlerësimi profesional si vijon:

1.1 Për aftësitë profesionale është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit; ka aftësi në drejtim të arsytimit ligjor.

1.2 Për aftësitë organizative është konstatuar se gjyqtari Izet Kadana ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë; ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota, por janë evidentuar parregullsitë si vijojnë :

- a. Kohëzgjatja e gjykimeve në tre çështje ka qenë brenda afatit standard të caktuar nga pika 5 e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit duke respektuar standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ndërsa në dy raste ka qenë tej afatit të parashikuar.
- b. Në tre raste dosja gjyqësore dhe vendimi i arsyetuar janë depozituar jashtë afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurave Penale dhe afatit 10 ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurave Civile. Vetëm në një rast dokumentacioni në dosjen e vëzhguar ka të meta, pasi në dosje mungon dokumentimi i dy seancave gjyqësore të caktuara.
- c. Në dy raste dosja nuk është e sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale, pasi janë administruar më parë konkluzionet përfundimtare të palëve e më pas procesverbalet gjyqësore.
- d. Në katër raste gjyqtari në pjesën arsyetuese nuk ka përdorur shprehimisht ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës.

⁵⁶ Shih, raportin e dërguar me shkresën me nr. (***) prot., datë 17.07.2017, nga KLD-ja.

e. Në dy raste gjyqtari nuk ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes.

1.3 Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, është konstatuar 1 ankesë e vitit 2015, e verifikuar nga Inspektorati për etikën në komunikim të gjyqtarit Izet Kadana – konkretisht për dërgimin e disa *sms-ve*, por që nuk kishin të bënin me detyrën e gjyqtarit. Pas verifikimit, është sugjeruar dhe aplikuar tërheqje vëmendje me shkrim si dhe të mbahet për efekt vlerësimi profesional dhe etik; për integritetin është konstatuar se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm ; për paanësinë nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana.

1.4 Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional është konstatuar se, në drejtim të aftësisë së komunikimit, gjyqtari Izet Kadana, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Në drejtim të aftësisë për të bashkëpunuar, është konstatuar se në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. Në drejtim të gatishmërisë për tu angazhuar nuk janë konstatuar problematika.

2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme zyrtare, si më poshtë vijon:

2.1 Për subjektin e rivlerësimit ka tre denoncime nga publiku ⁵⁷, të cilat i përmbushin kriteret e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në asnjë prej denoncimeve nuk ka të dhëna konkrete për përfshirjen e mundshme të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, në veprimtari korruptive. Nga shqyrtimi i denoncimeve dhe akteve bashkangjitur, Komisioni, vlerësoi se nuk ka pasur shkaqe për analizimin e dosjeve përkatëse gjyqësore.

2.2. Informacioni i marrë nga KLD-ja për 5 dosjet e përzgjedhura me short si dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit:

Gjatë procesit të rivlerësimit profesional nga ana e Komisionit, u morën në shqyrtim dosjet e çështjeve të përzgjedhura nga subjekti dhe ato të shortuara, dhe u konstatuan të njëjtat mangësi si ato të vëna në dukje nga Inspektorati i Lartë i KLD-së.

2.3. Informacion i marrë nga KLD-ja, në lidhje me ankesën e shtetasës F. L.:

KLD-ja, në raportin e saj, nr. (***) prot., datë 17.07.2017, shprehet se është verifikuar një ankesë e vitit 2015 (brenda periudhës së vlerësimit) nga Inspektorati, për etikën në komunikim të gjyqtarit Izet Kadana, pas verifikimit të së cilës, është sugjeruar dhe aplikuar tërheqje vëmendje me shkrim për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana, duke u mbajtur në konsideratë për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

⁵⁷ Shih, denoncimet e protokolluara me shkresat, nr. (***) prot., datë 24.11.2017, nr. (***) prot., datë 16.11.2018, nr. (***) prot., datë 06.03.2018, në dosjen e Komisionit.

Gjatë hetimit administrativ, i është kërkuar informacion KLD-së lidhur me ankesën e shtetasës F. L., dhe ky institucion ka vënë në dispozicion dokumentet si vijojnë⁵⁸:

2.3.a. Ankesë e shtetasës F. L. protokolluar nga KLD-ja, me shkresë nr. (***)prot., datë 31.03.2015 (gjithsej 3 fletë) + 10 fletë fotografi të ekranit të telefonit *Nokia* ku shfaqen *sms-të* dërguara.

Në ankesën e saj, kjo shtetase pretendon se gjyqtari Izet Kadana, i ka sjellë shqetësime duke i dërguar 19 *sms* në numrin e saj të telefonit. Këto pretendime, sipas saj lidhen me aplikimin për punësim në pozicionin e kryesekretares/financieres, pranë Prokurorisë së Rrethit Pukë, vend për të cilin kishte aplikuar edhe bashkëshortja e subjektit, znj. S. K. Nëpërmjet këtyre mesazheve sipas denoncueses, ai e uronte për detyrën e re dhe e kërcënonte se nuk do ta lejonte të emërohej në atë vend pune.

2.3.b. Relatimi i inspektorit, z. I. S., datë 28.04.2015, mbi ankesën e shtetasës F. L., sipas të cilit ai sugjeron verifikimin e ankesës së shtetasës F. L., për shkelje të etikës jashtëgjyqësore të gjyqtarit Izet Kadana.

2.3.c. Shkresë, nr. (***) prot., datë 27.05.2015, të KLD-së drejtuar shtetasës F. L., me të cilën informohet ajo se pretendimet e saj do të verifikohen dhe se rezultati do të komunikohet zyrtarisht.

2.3.d. Urdhër verifikimi, nr. (***)prot., datë 27.05.2015, i kryeinspektores M. Xh., sipas të cilit është urdhëruar verifikimi i ankesës së shtetasës F. L.

2.3.e Akti i njoftimit të datës 08.06.2015 në zbatim të urdhrin të verifikimit nr.(***)prot., datë 27.05.2015, sipas të cilit janë njoftuar gjyqtari Izet Kadana dhe kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, z. B. N., bazuar në urdhrin e verifikimit.

2.3.f. Procesverbal i mbajtur në Pukë, më datë 08.06.2015, me deklarimet e subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, sipas të cilit rezulton se:

Subjekti i rivlerësimit kishte njohje prej kohësh me shtetasen F. L. duke qenë se ajo kishte punuar si financiare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë. Kjo shtetase, si dhe gruaja e tij, kanë aplikuar për një vend pune për kryesekretare/financiare pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë. Shtetasja F. L. dhe bashkëshorti i saj, i ishin shprehur paraprakisht bashkëshortes së subjektit, znj. S. K., se ajo nuk do të konkuronte.

Pasi subjekti ka marrë vesh nga Prokurori i Rrethit Pukë se ishin përzgjedhur dy kandidatura për tu vlerësuar, mes të cilave shtetasja F. L., dhe jo kandidatura e bashkëshortes së subjektit, ka pranuar se i ka dërguar shtetasës F. L. mesazhet e pretenduara, për shkak se është zhgënjyer prej saj dhe se sjelljet e saj i janë dukur hipokrite.

Nga ky proces verbal rezulton që subjekti ka deklaruar midis të tjerash : “... *pasi mbaroi faza e kandidaturave dhe ishte bërë propozimi për dy kandidatura, unë si palë e interesuar kam pyetur prokurorin e rrethit çfarë u bë me kandidaturën e bashkëshortes sime, dhe ai me tha që ajo nuk është propozuar duke u anashkaluar. E pyeta përse kishte ndodhur kjo gjë, por ai me tha se nuk*

⁵⁸ Shih, shkresë kthim përgjigje, nr. (***) prot, datë 31.10.2018, nga KLD, dhe aktet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

përgjigjem më gjatë. E pyeta se kush ishin personat e përzgjedhur dhe më tha se ishin F. L. dhe I. N.atë ditë që mora vesh që ishte përzgjedhur ajo (F. L.), nga telefoni im janë dërguar mesazhet.....

- Në mesazhin, nr. 9, subjekti ka shkruar: “U hoqe ndryshe, s’ka problem, çdo person punon për vete dhe e di të kaluarën dhe të ardhmen e vet, por unë nuk do rri rehat, do vlerësoj çdo gjë” ...

- Në mesazhin, nr. 10, subjekti shprehet se: “Menjëherë qysh sot do të njoftoj Prokurorinë e Përgjithshme për atë që e vlerësoj unë kush do jetë në atë punë, dhe mos të duket e lehtë, edhe pse s’do jete gruaja ime, s’besoj se do jenë ato njerëz që kanë punuar aty dhe nuk e meritojnë..”,

- Në mesazhin, nr. 11, midis të tjerave ka shkruar:”hajt a shohim kush jam unë....”.

Më tej në procesverbal, nga ana e subjektit referohet se: “ : ...Pas pak ditësh, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është kërkuar edhe dosja e bashkëshortes sime. Më vonë gjatë procedurës, Prokurori i Përgjithshëm ka dhënë leje për miratimin e kandidaturës së bashkëshortes sime në atë funksion...”.

2.3.e. Memo e datës 30.09.2015, e inspektorit I. S., sipas së cilës informohet se lidhur me ankesën e shtetas F. L., është konkluduar dhe sugjeruar, që gjyqtarit Izet Kadana, t’i tërhiqet vëmendja me shkrim duke u bërë ajo pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit dhe e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të tij, për komunikim jo etik jashtë gjyqësor me shtetasen F. L.

2.3.g. Shkresë nr. (***) prot., datë 02.11.2015, të KLD-së drejtuar shtetas F. L., me anën e të cilës ajo është informuar, për tërheqjen e vëmendjes me shkrim subjektit të rivlerësimit.

2.4.Nga analiza e akteve të mësipërme rezultoi e vërtetuar se:

2.4.a. Mes subjektit të rivlerësimit dhe ankueses F. L. vërtetohet se ka pasur një komunikim me 19 mesazhe nëpërmjet aparateve të tyre telefonikë⁵⁹ të nisura në datën 06.03.2015, ora 17:35, pasi subjekti i rivlerësimit ka mësuar nga drejtuesi i Prokurorisë Pukë, që kjo shtetase ishte një nga kandidatet për financiere/sekretare pranë Prokurorisë së Pukës, ndërsa bashkëshortja e tij nuk ishte kualifikuar.

2.4.b. Biseda është filluar me mesazh urimi nga ana e subjektit për shtetasen F. L. me rastin e pranimit të kandidaturës së saj, dhe vijon duke i shprehur pakënaqësi asaj për shkak se nuk ishte treguar e sinqertë.

2.4.c. Në vijim subjekti është shprehur me fjalë joetike, në të cilat kuptohet që ai do te ushtronte ndikimin e tij, lidhur me faktin se kush do të emërohej në atë vend pune.

2.4.d. Subjekti ka biseduar me drejtuesin e Prokurorisë Pukë, duke u interesuar për kandidaturën e bashkëshortes së tij.

2.4.e. Sipas deklarimeve të subjektit, pasi janë shkëmbyer mesazhet e sipërpërmendura, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është kërkuar dosja e bashkëshortes së subjektit, fakt që tregon vijimin e interesimit të tij. Më vonë gjatë procedurës, Prokurori i Përgjithshëm ka dhënë leje për miratimin e kandidaturës së bashkëshortes së subjektit, znj. S. K., në atë funksion.

⁵⁹ Shih mesazhet në përmbajtjen e aktesës së shtetas F. L., protokolluar me shkresën nr. (***) prot., datë 31.03.2015 të KLD-së, bashkëngjitur me shkresën kthim përgjigje, nr. (***)prot., datë 31.10.2018, të KLD-së, në dosjen e Komisionit.

2.4.f. Me shkresën nr. (***) prot., datë 25.02.2015, të Prokurorisë Pukë, është dërguar informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme sipas të cilit, për këtë pozicion pune kanë aplikuar 18 shtetas, por nga ana e Prokurorisë Pukë, pas vlerësimit të dosjeve, u propozuan emrat e F. L., I. N. dhe S. K.

2.4.g. Me shkresën nr. (***) prot., datë 05.03.2015 (një ditë përpara shkëmbimit të mesazheve) drejtuesi i Prokurorisë Pukë, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke i përcjelle vetëm dokumentet personale të znj. S. K. dhe jo të dy kandidatave të tjera, të propozuara më parë nga ai me shkresën nr. (***) prot., datë 05.03.2015.

2.4.i. Me shkresën nr. (***) prot., datë 19.03.2015, drejtuar Prokurorisë Pukë, rezulton që Prokurori i Përgjithshëm, ka dhënë pëlqimin për emërimin e znj. S.K., në detyrën e kryesekretares.

Nga të gjitha sa më sipër, Komisioni, krijoi bindjen se:

-Në dijeninë e subjektit, bashkëshortja e tij nuk ishte përzgjedhur, sipas konfirmimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Pukës.

-Gjuha e përdorur gjatë komunikimit me *sms* me shtetasen F. L., është e një zhargoni të rëndomte, duke i bërë të ditur kësaj shtetaseje, pozicionin e tij dhe mundësinë e ndikimit lidhur me pranimin e kandidatës më të mirë për pozicionin e punës në fjalë.

-Në mënyrë direkte ai është shprehur në mesazhe se do të interesohej për problemin në fjalë, dhe realisht është interesuar, për (mos) pranimin e kandidatës së bashkëshortes së tij, znj. S. K.

-Pas bisedës me subjektin e rivlerësimit, rezulton që drejtuesi i Prokurorisë Pukë, më datë 05.03.2015, i ka dërguar Prokurorisë së përgjithshme, vetëm dokumentet e bashkëshortes së subjektit. Fakti që nuk janë dërguar dokumentet e dy kandidateve të tjerë, tregon që znj. S. K., është favorizuar gjatë përzgjedhjes së kandidatës së saj.

Pra siç rezulton, pasi ka paralajmëruar me mesazhe, znj. F. L. më datë 06.03.2015, se do ta shohë se kush ishte ai dhe se do të interesohej për problemin në fjalë, ndikimi i subjektit për emërimin në detyrë të bashkëshortes së tij, tashmë ishte kryer.

Bazuar në nenin 103, germa d, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron, ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit, konsiderohet si shkelje disiplinore.

Barra e provës:

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 842016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, iu kalua subjektit barra e provës për sa më sipër.

Në parashtrimet e datës 17.12.2018 dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka pranuar se ka gabuar gjatë komunikimit nëpërmjet *sms-ve* me shtetasen F. L., duke u justifikuar se komunikimi mes tyre nuk ka qenë për shkak të detyrës, por për shkak të marrëdhënies shoqërore që ka pasur me të.

Në lidhje me mungesën e etikës gjate komunikimit me shtetasen F. L., subjekti e pranoi se ka qënë një gabim i tij, por që nuk kishte lidhje me ushtrimin e detyrës.

Ne lidhje me ndikimin e tij për emërimin në detyrë të bashkëshortes, znj. S. K., subjekti mohon të ketë ndikuar, duke sqaruar se nuk ka asnjë njohje, lidhje apo komunikim me asnjë nga personat që e kanë emëruar, gjë që nuk rezultoi e vërtete nga analiza e të gjitha provave të grumbulluara. Veç kësaj, ai nuk ka paraqitur asnjë prove për të provuar të kundërtën.

3. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas kritereve të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në faktet dhe provat që Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit:

3.1. Ka treguar aftësi të mira profesionale bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

3.2. Ka treguar mjaftueshëm aftësi organizative bazuar në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016.

3.3. Ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional në ushtrimin e detyrës bazuar në nenin 76 të ligjit nr. 96/2016.

3.4. Në drejtim të etikës dhe vlerave profesionale, bazuar në nenin 75 të ligjit nr. 96/2016, ka rezultuar se:

-Gjatë komunikimit me *sms* me shtetasen F. L., subjekti ka përdorur fjalë dhe reflektuar sjellje që vijnë në kundërshtim me etikën e një gjyqtari.

-Duke përdorur pozitën, subjekti ka kryer veprime që tregojnë në mënyre direkte ose indirekte, ndikimin e tij për emërimin në punë të bashkëshortes së tij, duke përfutur kështu një favor për shkak të detyrës.

-Subjekti i rivlerësimit ka pasur konflikt interesi në shqyrtimin e çështjes ku shtetasi A. P., ka qënë me cilësinë e të dëmtuarit akuzues.

Rezultatet e rivlerësimit profesional:

Bazuar në sa më sipër, edhe pse u vlerësua se subjekti ka arritur nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, aftësive organizative, aftësive personale dhe angazhimin profesional, Komisioni krijoi bindjen se cënimi i etikës gjatë komunikimit me shtetasen F. L. (një nga kriteret e vlerësimit profesional sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë,) si dhe qëndrimet dhe ndikimi i tij në lidhje me emërimin në detyrë të bashkëshortes znj. S. K. në pozicionin e kryesekretares/ekonomistes në Prokurorinë e Rrethit Pukë, të provuara gjatë procesit të rivlerësimit, ndikojnë drejtpërdrejt në cënimin e besimit të publikut te subjekti i rivlerësimit, si pjesë e sistemit të drejtësisë.

Sipas nenit E, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës, për sjellje të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 46 të ligjit 84/2106, dhe në përfundim, është konstatuar se ai ka bashkëpunuar mjaftueshëm me Komisionin.

Gjithashtu, është konstatuar se në pergjigjet e tij, ai ka qënë herë herë kontradiktor, dhe i pasinqertë. Po kështu, ka kërkuar dy herë shtyrjen e afatit për të ushtruar të drejten e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit 84/2016. Në të dyja rastet, ai ka pretenduar se ka qënë në pamundësi objektive për tu paraqitur pranë institucioneve përkatëse dhe Komisionit, për të tërhequr dokumenta (në kërkesën e parë ka paraqitur bashkëngjitur raport mjekësor me afat gjashtëditor), ndërkohë, që sipas nenit 70 e vijuesa të K.C, ai ka pasur të drejtë që të caktonte një përfaqësues ligjor, duke i dhënë të drejtat si më sipër.

Qëndrimi i tij, gjatë procesit të rivlerësimit, është mbajtur në konsideratë në procesin e vendimarrjes nga ana e trupit gjykues, sipas nenit 48 të ligjit 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 18.12.2018 u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, gjatë së cilës ai paraqiti parashtrimet e tij dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi që vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, të bazohet në vlerësimin tërësor të të tria kritereve, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, shpall këtë vendim sot, në datën 20.12.2018, sipas nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Kadana, nuk ka arritur nivel të besueshëm për vlerësimin e figurës.

3. Referuar Aneksit të Kushtetutës, neni E, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, kreu VI, të ligjit nr. 96/2016, kreu II, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka reflektuar sjellje të papërshtatshme për pozicionin e tij si gjyqtar, duke cenuar etikën e gjyqtarit.

4. Në vlerësim të përgjithshëm të të gjitha rrethanave, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e

pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, parashikuar nga neni 61, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas nenit 58, pika 1, germa “a”, bazuar nenin 61 pikat 2, 3 dhe 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikën 3 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Kadana, me detyrë gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë e publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 20.12.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues
Lulzim HAMITAJ

Anëtar/Relator
Firdes SHULI

Anëtar
Xhensila PINE

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta